REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 973/23
Datë/Datum. 08.12.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0973
Data e Vendimit: 08.12.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik "Eco Holding Group" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Granti performancës 2023 Ndërtimi i Sheshit në qendër të Vitisë - faza III" me numër të prokurimit 657-23-13166-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Viti, Kryetari i panelit shqyrtues, Isa Hasani me datën 08.12.2023, mori këtë

Vendim

1. Hedhet si e palejuar, ankesa e "Eco Holding Group" SH.P.K. me Nr. të Protokollit 2023/0973, e datës 04/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Granti performancës 2023 Ndërtimi i Sheshit në qendër të Vitisë - faza III" me numër të prokurimit 657-23-13166-5-2-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal Viti në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

2. I lejohet autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Viti që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Granti performancës 2023 Ndërtimi i Sheshit në qendër të Vitisë - faza III" me numër të prokurimit 657-23-13166-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 04.12.2023, ka pranuar ankesën me Nr. Protokolli 973/23 nga OE "Eco Holding Group" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Granti performancës 2023 Ndërtimi i Sheshit në qendër të Vitisë - faza III" me numër të prokurimit 657-23-13166-5-2-1, inicuar Kuvendi Komunal Viti në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 23.11.2023, Kuvendi Komunal Viti në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për kontratën, ndërsa afati i fundit për pranimin e tenderëve ka qenë 04.12.2023

Me 30.11.2023 OE "Eco Holding Group" SH.P.K., kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 04.12.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të jashtafatshme.

- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Granti performancës 2023 Ndërtimi i Sheshit në qendër të Vitisë - faza III" me numër të prokurimit 657-23-13166-5-2-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal Viti në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK). AK ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë në sistemin e-prokurimi me datë 23.11.2023.

OE "Eco Holding Group" SH.P.K., kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 30.11.2023 në ora 13:56, parashtron kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

Me 04.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të jashtafatshme sepse e njëjta nuk është dorëzuar brenda afateve kohore të përcaktuara ne nenin 4 të këtyre rregullave .

-Përfundim-

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *ne qoftë se shkelja e supozuar ka te bej me njoftimin e kontratës ose dokumentet e tenderit brenda pesë(5)ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.* Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se*

paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Përfundimisht nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 04.12.2023, nga OE "Eco Holding Group" SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit "Granti performancës 2023 Ndërtimi i Sheshit në qendër të Vitisë - faza III" me numër të prokurimit 657-23-13166-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues AK –Kuvendi Komunal Viti, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën përrishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit në rrethana të tilla sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 5, 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

OSHP gjithnjë niset nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Andaj, Autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Viti, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhettë veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP- së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetari i panelit shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.